

Dokument i përditësuar për Delegacionin Shtetëror të Republikës së Kosovës mbi fazën përfundimtare të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, të lehtësuar nga Bashkimi Evropian

Prishtinë, 21 janar 2019

1. Sfondi i fazës përfundimtare

Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës ka përgatitur këtë dokument informues për Delegacionin Shtetëror të Republikës së Kosovës, me qëllim që ta informojë dhe ndihmojë atë, në përmbushjen e detyrave të përcaktuara në bazë të “Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës mbi procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë” të datës 15 dhjetor 2018.

Kjo është një përmbledhje që përmban të gjitha hollësitë relevante dhe të nevojshme për informim të delegacionit për zhvillimet, qëndrimet, qasjen dhe kontekstin në fazën e përfundimtare të dialogut të nivelit të lartë politik.

Në këtë kontekst, Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, që nga 24 qershori 2018, ka zhvilluar katër raunde të takimeve në kuadër të dialogut për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, me ftesë të lehtësueses të këtij procesi, znj. Federica Mogherini, Përfaqësuese e Lartë Politikë Jashtme dhe Politikë të Sigurisë të Bashkimit Evropian, njëherësh Zëvendës Presidente e Komisionit Evropian.

Në takimet e datave 24 qershor 2018, 18 korrik 2018 dhe 8 Nëntor 2018, përveç takimeve dypalëshe mes Kosovës dhe BE-së janë zhvilluar edhe takime tri-palëshe (Kosovë, BE, Serbi) në nivel të presidentëve dhe takimet janë lehtësuar nga ana e BE-së, përkatësisht Përfaqësueses së Lartë, znj. Federica Mogherini, dhe me prezencë të stafit të Shërbimit për Veprim të Jashtëm të BE-së (EEAS) në Bruksel.

Në raundin e 18 Korrikut, në takim bilateral me BE-në delegacioni i Kosovës ka qenë në përbërje edhe të përfaqësuesve tjerë institucional të Kosovës përfshirë Kryetarin e Kuvendit, z. Kadri Veseli, Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, Zëvendës Kryeministrat z. Behgjet Pacolli, z. Fatmir Limaj dhe z. Dardan Gashi.

Ndërsa, në raundin e datës 7 shtator, Përfaqësuesja e Lartë e BE-së, znj. Mogherini ka mbajtur vetëm takime bilaterale me të dy presidentët dhe sipas vlerësimit të saj, në pamundësi të përafrimit të pikëpamjeve, nuk është organizuar një takim trepalësh.

2. Pozicionet e përgjithshme

Në të gjitha këto takime pozicioni i paraqitur i Kosovës ka qenë në funksion të arritjes së një marrëveshjeje përfundimtare, gjithëpërfshirëse, në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë, që do të përfundojë me njohjen e Kosovës nga Serbia dhe që siguron anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Bazuar në këto qëllime, ne vazhdimisht kemi ripërsëritur qëndrimin tonë se një marrëveshje e tillë duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe të ketë karakter detyrues ligjor. Për më tepër, ne kemi kërkuar që një marrëveshje e tillë e mundshme, të ketë edhe mbështetjen e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, dhe kjo të rezultojë në njohje të plotë nga BE, gjë që nënkupton mënjanimin e pengesave ekzistuese politike në rrugën e Kosovës për anëtarësim në Bashkim Evropian, në pajtim me kriteret e procesit të zgjerimit të BE.

Vlen të përmendet që në kontekstin e shkëmbimeve të ndërlidhura me krijimin e një situatë të favorshme për dialog dhe arritjen e marrëveshjes eventuale, në raport me palën e BE-në, është përsëritur kërkesa për përshtetimin e procesit të shpalljes së përmbushjes së kriterëve për liberalizim të vizave, dhe pastaj edhe për përshtetimin e procesit vendimmarrës të BE, drejt vendimit përfundimtar dhe meritore për lëvizjen e lirë dhe pa viza të qytetarëve të Kosovës në Bashkim Evropian. Në këtë drejtim, një pjesë e diskutimeve kanë përmbajtur edhe tema të ndryshme të zhvillimeve të vazhdueshme, që palët kanë konsideruar si ndikuese në dinamikën e procesit të dialogut, por edhe përmbajtjes së marrëveshjeve të kaluara. Kjo përfshin çështjet e ndërlidhura me procesin e anëtarësimit të Kosovës në Interpol, ku ne kemi kërkuar që urgjentisht të ndalet fushata e Serbisë kundër Kosovës duke argumentuar që qasjet e tilla, janë në kundërshtim me frymën e marrëveshjes për përfaqësim rajonal të Kosovës etj.

Çështjet tjera të kësaj natyre që janë ngritur kanë qenë po ashtu procesi i tranzicionit të FSK-së dhe veprimet e frikësimit e të presionit të Serbisë ndaj

pjesëtarëve të komunitetit Serb, anëtar të FSK-së, masat tarifore ndaj produkteve me origjinë në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë etj.

Një element i diskutuar në vazhdimësi ka qenë edhe krijimi i një baze sa më të gjerë të përfshirjes në dialog të të gjithë aktorëve relevantë në Kosovë, me qëllim që të arrihet një konsensus sa më i gjerë i mundshëm. Arritja e konsensusit jo vetëm që e forcon pozitën dialoguese të Kosovës, por siguron që të kemi një marrëveshje të arritshme, të zbatueshme dhe të qëndrueshme. Votimi i Rezolutës së Kuvendit të Kosovës për dialog dhe themelimi i Delegacionit Shtetëror të Kosovës është në funksion të këtij qëllimi, gjë që është në përputhje me angazhimet e deritanishme në interesin tonë shtetëror.

Me insistimin tonë, Bashkimi Evropian, në rolin e lehtësuesit të dialogut në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë, ka shqyrtuar një sërë temash të konsideruara të rëndësishme. Qëllimi i kësaj faze përfundimtare është diskutimi për të gjitha çështjet e hapura në mes të Kosovës dhe Serbisë, sepse ne nuk duam që të arrijmë vetëm edhe një marrëveshje tjetër. Pra, ne duam që kjo marrëveshje të jetë përfundimtare dhe të shënojë normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet të dy shteteve. Përfaqësuesja e Lartë e BE-së, znj. Mogherini dhe kabineti i saj, kanë mbajtur takime bilaterale me delegacionin e Kosovës, para takimeve tri-palëshe presidenciale Kosovë-BE-Serbi, në të cilat është punuar në temat që do të përbënin thelbin e bisedimeve të mëtutjeshme.

Në këto takime, si dhe në çdo komunikim tjetër që Presidenca ka pasur me Përfaqësuesen e Lartë të BE-së, znj. Federica Mogherini dhe me përfaqësuesit e saj, qëndrimi i palës kosovare ka qenë se të gjitha temat që do të trajtohen, për palën kosovare kanë domethënie të shqyrtimit të pikave të veçanta të një Marrëveshjeje Gjithëpërfshirëse në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, e detyrueshme ligjërish, e cila do të nënkuptojë njohjen formale reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Ndonëse për këto tema, të cilat listohen më poshtë, është biseduar në të gjitha takimet, nuk është arritur akordim në mes Kosovës dhe BE-së, pra nuk paraqet pozicion të finalizuar të Republikës së Kosovës apo të pranuar nga ana BE-së. Më poshtë janë të gjitha pikat që janë diskutuar në këto takime e që janë përmendur si elemente të mundshme të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse.

Sa i përket BE-së, qëndrimi i përsëritur i Përfaqësueses së Lartë për rregullat e angazhimit të BE-së në këtë proces, ka qenë ai që dialogun e konsideron pronësi të palëve dhe se arritja e një marrëveshje, është përgjegjësi dhe mundësi për palët, si për të tejkaluar gjendjen e tanishme të status quo-së, ashtu edhe përmbylljen e çështjeve të hapura. Vetëm arritja e marrëveshjes mundëson avancimin në procesin e integritimit evropian për të dy vendet. Në të njëjtën kohë, është thënë qartë, BE do të mbështes një marrëveshje që ka pajtim të përbashkët, që do të ishte në pajtim me ligjin ndërkombëtar, vlerat e Bashkimit Evropian, që do të ruante karakterin shumë-etnik dhe që do të nënkuptonte mbrojtje të të drejtave të komuniteteve pakicë. BE e sheh këtë marrëveshje si një dokument obligues ligjor dhe është vënë në dukje përkushtimi për rolin promovues të kësaj marrëveshje më rrafsh ndërkombëtar, në koordinim me partnerët dhe aleatët tanë ndërkombëtar.

Gjithashtu, në këtë frymë theksohet edhe bashkëpunimi dhe koordinimi i ngushtë i palës së Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe BE-së përgjatë gjithë procesit.

Vërejtje:

Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës konfirmon zyrtarisht, se deri më tani, BE-ja dhe të dy shtetet e përfshira në këtë proces, nuk kanë prodhuar asnjë dokument të shkruar zyrtar i cili do të mund të konsiderohej si një draft fillestar për marrëveshje. Të gjitha çështjet e diskutuara deri më tani, janë ende të hapura.

Në këtë proces të fazës përfundimtare, vlen parimi i dakorduar ndërmjet palëve; “asgjë nuk mund të konsiderohet si e pranuar, derisa marrëveshja në të tërësi nuk është e pranueshme”. Ndërsa, në rast se Ekipi Negociator dëshiron të këtë në dispozicion materialin dhe marrëveshjet e arritura në kuadër të këtij proces që nga fillimi e deri më tani, atëherë adresa e vetme është Qeveria e Republikës së Kosovës.

3. Çështjet specifike të diskutuara në kuadër të fazës përfundimtare

i. Personat e pagjetur

Kjo temë ka qenë gjithmonë prioritet për ne, prandaj kemi insistuar që të jetë tema e parë. Kjo çështje delikate, e dhimbshme dhe humane, është trajtuar me seriozitetin më të madh të mundshëm në bisedimet që Presidenti ka pasur me përfaqësuesit e Zyrës së Përfaqësueses së Lartë të BE-së, znj. Federica Mogherini.

Për të zgjidhur këtë çështje, në parim ka sinjale të përkrahjes për idenë e emërimit të një Emisari Special, që njëkohësisht do të ishte dhe Kryesues i Komisionit të përbashkët në mes të përfaqësuesve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, që do të merrej me temën e personave të pagjetur.

Mendohet që propozimin për Kryesuesin e këtij Komisioni të përbashkët duhet ta bëjë Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, që është marrë me këtë temë që prej përfundimit të luftës në Kosovë dhe deri më tash. Pala jonë mendon që Kryetar i këtij Komisioni duhet të jetë një diplomat me përvojë në rajonin tonë, që njeh zhvillimet dhe historinë e rajonit.

Është menduar edhe për afatin kohor për përmbylljen e kësaj çështjeje. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq do të duhej brenda një periudhe maksimalisht katërvjeçare ta përmbyllë këtë temë në Kosovë, Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë.

Në rastin e Kosovës dhe në kontekst të Marrëveshjes së mundshme gjithëpërfshirëse, propozimi i Përfaqësueses së Lartë të BE-së, znj. Mogherini është që afati për mbylljen e çështjes së të pagjeturve të jetë dymbëdhjetë muaj.

ii. Personat e zhvendosur

Për të zhvendosurit, apo të drejtës së refugjatëve/personave të zhvendosur për kthimin në shtëpitë/banesat e tyre në Kosovë, është propozuar që në kuadër të kësaj çështjeje të trajtohet edhe tema e shqiptarëve të larguar nga tri komunat e Luginës së Preshevës (Preshevë, Bujanovc, Medvegje), për të instaluar dhe respektuar parimin e reciprocitetit.

Përfaqësuesit e EEAS kanë bërë një Propozim shtesë, sipas të cilit të zhvendosurit të kenë të drejtë të kthehen jo vetëm në vendin ku kanë jetuar më parë, por kudo ku dëshirojnë dhe aty ku ka kushte. Ky formulim është i njëjtë edhe me Propozimin Gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisaari.

iii. Trashëgimia Kulturore

Është kjo një temë që ka një interesim të veçantë nga ana e EEAS-it dhe natyrisht edhe nga Serbia. Përfaqësuesit e zonjës Mogherini, përkundër shpjegimeve tona për karakterin sekular të shtetit të Kosovës dhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, insistojnë se do të ishte mirë që përmes amendamentimit të Kushtetutës së Kosovës (pas ratifikimit të marrëveshjes eventuale ligjërishit detyruese në mes të Kosovës dhe Serbisë) të bëhej garantimi i të drejtave dhe privilegjeve të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë; dhe që të specifikohet në Kushtetutë që selia e kësaj Kise është në Beograd.

Ne kemi argumentuar se: garancitë e kërkuara mund të adresohen vetëm nëpërmjet ndryshimeve ligjore në ligjet relevante, të cilat mbulojnë këtë fushë.

Sidoqoftë, sa i përket statusit të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë, në Zyrën e znj. Mogherini bindja mbizotëruese është që Aneksi V i Propozimit Gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisaari dhe Korniza legale e Kosovës, që ka reflektuar këtë Propozim, është një bazë shumë e mirë/ adekuate ligjore për të akomoduar statusin e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë.

iv. Prona

Kjo pikë ka përfshirë çështjet pronësore në disa nivele – çështjen e pronës private; çështjen e pronës publike/shtetërore/shoqërore; kompensimet për palët e dëmtuara.

Ne kemi theksuar se prona private në Kosovë garantohet për të gjithë dhe kemi kërkuar implementimin e plotë të marrëveshjes për kadastrat, si mënyra më e mirë për sqarimin e kontesteve pronësore, në rastet e pronës private.

Sa i përket temës së pronës publike dhe shoqërore në territorin e Republikës së Kosovës, pozicioni ynë ka qenë i qartë: Sipas Propozimit të Presidentit Ahtisaari, e gjithë prona publike dhe shoqërore në territorin e Republikës së Kosovës i takon Kosovës. Këtu kemi hasur në mirëkuptim nga ana e përfaqësuesve të EEAS-it.

Gjithashtu, kemi sqaruar se procesi i privatizimit të pronës shoqërore është nisur nga UNMIK, përmes Rregullores gjegjëse të Kryeadministratorit Michael Steiner, me themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

Në kuadër të konceptit të kompensimit, ne kemi ngritur kërkesën për dëmshpërblim për të gjitha dëmet materiale të shkaktuara në Kosovë gjatë luftës (1998, 1999), si dhe për kthimin e Fondit Pensional në Kosovë, të cilin e ka marrë Serbia në vitin 1999.

Përfaqësuesit e Përfaqësueses së Lartë të BE-së, znj. Mogherini kanë theksuar që nëse do të ketë Marrëveshje Gjithëpërfshirëse në mes të Kosovës dhe Serbisë, atëherë gjithsesi do të ketë edhe Konferencë të donatorëve për ta përkrahur zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

v. Të drejtat e minoriteve/ komuniteteve jo-shumicë

Parimi i parë dhe kryesor për të cilin ka insistuar Presidenti i Kosovës në takimet në Bruksel është ai i Reciprocitetit të plotë sa i përket të drejtave të komunitetit serb në Republikën e Kosovës dhe të drejtave të komunitetit shqiptar në Luginën e Preshevës.

Nga ana e jonë është bërë e qartë se korniza kushtetuese e ligjore e Kosovës ofron mundësi të mëdha të cilat mund të shfrytëzohen nga Serbia për të mbështetur komunitetin serb në Kosovë. Por, është përjashtuar mundësia që Qeveria e Serbisë të ketë mundësi të ushtrojë çfarëdo pushteti ekzekutiv në Kosovë, në cilëndo fushë.

Gjithashtu, është diskutuar edhe për përmbajtjen e Nenit 81 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që merret me respektimin e interesave vitale të komuniteteve pakicë. Në parim, ka përkrahje për idenë që ndryshimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pas arritjes së Marrëveshjes ligjërishit detyruese në mes të Kosovës dhe Serbisë, të bëhet proces më i lehtë, duke iu shmangur Parimit të shumicës së dyfishtë, pa prekur ndryshimet në legjislacion me interes vital për komunitetet.

Është diskutuar edhe çështja e të drejtës së serbëve të Kosovës për të votuar në zgjedhjet e Serbisë dhe e organizimit të këtyre zgjedhjeve në territorin e

Republikës së Kosovës. Janë shqyrtuar praktika evropiane për rastet e ngjashme. Edhe këtu pala kosovare ka kërkuar reciprocitet në mes të Kosovës dhe Serbisë.

vi. Kthimi i artefakteve arkeologjike dhe etnologjike në Kosovë

Presidenti në të gjitha takimet ka shtruar kërkesën për kthimin e të gjitha artefakteve historike e kulturore të Kosovës, të cilat janë në posedim të Serbisë, që nga përfundimi i luftës, në vitin 1999. Ka pasur mirëkuptim të plotë nga Zyra e Zonjës Mogherini për këtë çështje.

Do të duhej të përcaktohej afati kohor brenda të cilit, pas Ratifikimit të Marrëveshjes Gjithëpërfshirëse në mes të Kosovës dhe Serbisë, do të duhej të ktheheshin në Kosovë të gjitha artefaktet arkeologjike dhe etnologjike, që gjenden në Serbi.

vii. Marrëveshjet që janë arritur në kuadër të dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian

Është kërkuar që të gjitha marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut teknik dhe politik në periudhën 2011-2015 të implementohen, si pjesë e Marrëveshjes Gjithëpërfshirëse.

Kërkesa është përkrahur, ndonëse qëndrimi i Zyrës së EEAS-it është që vëmendja e Zyrës së znj. Mogherinit si dhe i autoriteteve negociatore të Kosovës dhe të Serbisë duhet të jetë në arritjen e Marrëveshjes Ligjërish Detyruese në mes të Kosovës dhe Serbisë.

viii. Bashkëpunimi ekonomik/ infrastrukturor

Sipas shpjegimeve të ofruara nga bashkëbiseduesit tonë në Zyrën e EEAS-it, këtu është fjala për vazhdimësi të bashkëpunimit në kuadër të Procesit të Berlinit, të nisur në vitin 2014.

Parimisht, ky është një proces që edhe në të kaluarën është përkrahur prej të gjitha institucioneve të Kosovës.

ix. Zbatimi dhe respektimi i kësaj Marrëveshjeje

Kjo temë është iniciuar nga Zyra e Përfaqësues së Lartë për të inkurajuar identifikimin e modaliteteve për procedurën vendore dhe ndërkombëtare të Ratifikimit të Marrëveshjes Gjithëpërfshirëse midis Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve.

Ne kemi ofruar shpjegimet e përgjithshme se si do të duhej të ndodhte Ratifikimi i kësaj Marrëveshjeje në Kosovë, por edhe faktin pse është e domosdoshme që të zëvendësohet Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (që do të paraqiste përfundimit të mandatit të UNMIK-ut në Kosovë) me një Rezolutë të re të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, e cila do ta fuqizonte Marrëveshjen në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Kjo procedurë ndërkombëtare është parakusht që Republika e Kosovës të aplikojë për anëtarësim në OKB.

Natyrisht, Bashkimi Evropian do të mbetet garantues i zbatimit të kësaj marrëveshjeje dhe do të themelohen mekanizma të veçantë të përbashkët për monitorim të zbatimit.